

# Qeverisja e Mirë në Sigurinë Kibernetike në Kosovë: Forcimi i themeleve dhe i institucioneve të reja

---

Shtator 2022



“Qeverisja e Mirë në Sigurinë Kibernetike në Kosovë: Forcimi i themeleve dhe i institucioneve të reja”

Ky publikim është pjesë e projektit “Qeverisja e Mirë në Sigurinë Kibernetike në Ballkanin Perëndimor” të DCAF - Qendrës të Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë, i mbështetur nga FCSO - Zyra e Jashtme për Komonvelt dhe Zhvillim e Mbretërisë së Bashkuar.

Pikëpamjet, gjetjet dhe opinionet në këtë publikim janë vetëm ato të autorëve dhe si të tilla nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e DCAF.

Përgatitur nga: **Lulzim Peci dhe Valdrin Ukshini**

Copyright © 2022, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0)38 542 778

[www.kipred.org](http://www.kipred.org)

# Hyrje

Ky punim parashtroi sfidat kryesore të të drejtave të njeriut në raport me sigurinë kibernetike në Kosovë për t'i identifikuar çështjet kritike që kërkojnë ndërhyrje dhe përmirësime të mundshme. Për këtë qëllim ky studim përqendrohet në dimensionet e sigurisë kibernetike të ndërlidhura me të drejta të veçanta të njeriut.

Punimi është i ndarë në tri pjesë kryesore: në kontekstin e sigurisë kibernetike në Kosovë; në sigurinë kibernetike dhe të drejtat e njeriut, me një përqendrim të veçantë në të drejtën në privatësi, në lirinë e shprehjes, lirinë e grumbullimit dhe në anti-diskriminim; si dhe në rekomandime. Pjesa e parë ofron një përmbledhje të shkurtër të legjislacionit të zbatueshëm, si dhe të politikave dhe palëve të interesuara përkatëse. Pjesa e dytë shqyrton përmasën deri në të cilën siguria kibernetike në Kosovë është në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe nivelin e koordinimit ndërmjet institucioneve të ndryshme të përfshira në mbrojtjen e këtyre të drejtave në praktikë.

Punimi përfundon duke ofruar rekomandime dhe sugjerime të veçanta për përmirësimin e kornizave ligjore dhe të politikave që ndërlidhen me sigurinë kibernetike dhe të drejtat e njeriut në Kosovë.

Kjo ndërmarrje hulumtuese është e bazuar në një masë të madhe në burimet parësore në vijim: në kornizën ligjore të Kosovës, në opinionet e Komisionit të Venedikut dhe në dokumentet e Këshillit të Evropës; në raportet zyrtare të Bashkimit Evropian (BE) dhe të Departamentit Amerikan të Shtetit; dhe në intervistat me përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Ekonomisë, Policisë së Kosovës, Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës (IAPK), të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, dhe të Njësisë Kombëtare të Sigurisë Kompjuterike (KOS-CERT), si dhe me një ekspert nga akademia, dhe dy ekspertë nga shoqëria civile. Ky studim ka përdorur po ashtu edhe një varg burimesh dytësore të tilla si raporte hulumtuese dhe raportimet mediale.

# Konteksti i sigurisë kibernetike në Kosovë

Kjo pjesë e ofron një pasqyrë të ligjeve, politikave, strategjive dhe të palëve të interesuara, të ndërlidhura me sigurinë kibernetike në Kosovë. Kjo i shqyrton institucionet kryesore përgjegjëse për sigurinë kibernetike, rolet e tyre dhe nivelin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm – përfshirë këtu, palët e interesuara, si shtetërore, ashtu edhe ato joshtetërore.

Para Shpalljes së Pavarësisë në shkurt 2008, korniza ligjore dhe politike e sigurisë kibernetike në Kosovë në thelb nuk ekzistonte. Korniza filloi të zhvillohej gjatë viteve të para të pavarësisë dhe ky zhvillim është duke vazhduar ende. Në këtë drejtim, akti i parë ligjor i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 10 qershor 2010, ishte Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik.<sup>1</sup> Ky ligj e jep bazën ligjore për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik dhe për sanksionimin e shkeljeve, duke iu përmbajtur të drejtave të njeriut dhe duke mbrojtur të dhënat personale.<sup>2</sup> Ky krimin kibernetik e përkufizon si një veprimtari kriminale që kryhet në një rrjet, dhe që ka si qëllim, ose e përfshin në mënyrën se si kryhet, keqpërdorimin e sistemeve kompjuterike dhe të të dhënave kompjuterike.<sup>3</sup>

Në vitin 2012, Kuvendi i Kosovës miratoi dy ligje lidhur me sigurinë kibernetike. Ligji për Shërbimet e Shoqërisë Informatike, i miratuar më 15 mars 2012,<sup>4</sup> që rregullon shërbimet elektronike (e-tregtinë, e-pagesën, e-bankimin, e-qeverisjen, dhe e-prokurimin) si dhe shfrytëzimin e nënshkrimeve elektronike nga ana e qeverisë, bizneseve dhe qytetarëve të Kosovës. Ky ligj synon t'i zvogëlojë problemet dhe keqpërdorimet

e mundshme që kanë të bëjnë me transaksionet elektronike, si dhe ta mbrojë sigurinë e sistemeve të informimit.<sup>5</sup> Pos kësaj, Ligji për Komunikimet Elektronike, i miratuar më 4 tetor 2012,<sup>6</sup> i siguron normat ligjore për shfrytëzimin e komunikimeve elektronike, dhe e siguron mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtës së privatësisë në këtë fushë.<sup>7</sup>

Një akt tjetër ligjor i shpallur në vitin 2012 nga Kuvendi i Kosovës që ka të bëjë me sigurinë kibernetike është Ligji për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike, që u miratua më 28 maj 2015.<sup>8</sup> Ky ligj e plotësoi një boshllëk të madh në qeverisjen e sigurisë kibernetike dhe të të drejtave të njeriut në Kosovë, duke rregulluar procedurat dhe kushtet për përgjimin e komunikimeve elektronike që kanë të bëjnë me procedurën penale, sigurinë kombëtare dhe sigurinë e qytetarëve të saj. Ligji përcakton detyrimet dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse shtetërore në lidhje me përgjimin e ligjshëm – përfshirë këtu procedurat për mbikëqyrjen e zbatimit të tij – dhe me mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut.<sup>9</sup>

Për më tepër, Ligji për Infrastrukturën Kritike, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 30 mars 2018,<sup>10</sup> ofron dispozitat ligjore për rregullimin e infrastrukturës kritike në Kosovë. Ky i identifikon sektorët përkatës, ofron udhëzime si të menaxhohen ata, dhe përcakton ndëshkimet për mospajtim.<sup>11</sup> Lidhur me këtë, ligji, ndër të tjera, identifikon teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit (TIK) si një sektor infrastrukturor kritik.<sup>12</sup> Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i miratuar

1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik (Ligji Nr. 03/L-166), 20 korrik 2010.

2 Ibid., Neni 1.

3 Ibid., Neni. 31.

4 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Shërbimet e Shoqërisë Informatike (Ligji Nr. 04/L-094), 11 prill 2012.

5 Ibid., Neni 1.

6 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Komunikimet Elektronike (Ligji Nr. 04/L - 109), 9 nëntor 2012.

7 Ibid., Neni. 2.

8 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike (Ligji Nr. 05/L - 030), 13 korrik 2015.

9 Ibid., Neni 1.

10 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Infrastrukturën Kritike (Ligji Nr. 06/L - 014), 27 prill 2018.

11 Ibid., Neni 2.

12 Ibid., Neni 5.2.7.

nga Kuvendi i Kosovës më 30 janar 2019,<sup>13</sup> ishte akti i fundit i miratuar ligjor lidhur me qeverisjen e sigurisë kibernetike në Kosovë. Ligji përcakton mbrojtjen ligjore, përgjegjësitë institucionale për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave, dhe qasjen në dokumentet publike, si dhe sanksionimet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë së individëve.<sup>14</sup> Ky ligj është po ashtu në përputhje me Direktivën 95/46/EC të Komisionit të BE-së për Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave.<sup>15</sup>

Qeveria e mëparshme e Kosovës e kishte përgatitur Projektligjin e ri për Sigurinë Kibernetike në vitin 2020,<sup>16</sup> mirëpo, për shkak të zgjedhjeve të jashtëzakonshme të shkurtit 2021, ky ligj nuk është miratuar ende nga Kuvendi i Kosovës.

Politika e parë lidhur me sigurinë kibernetike në Kosovë – Politika e Sektorit të Elektronikës dhe të Komunikimit – Agjenda Digjitale për Kosovën 2013–2020 – u hartua në marsin e vitit 2013 nga Ministria e atëhershme e Ekonomisë,<sup>17</sup> dhe i kishte qëllimet në vijim: ta zhvillojë TIK-un; t'i zhvillojë përmbajtjet dhe shërbimet elektronike dhe ta përhapë përdorimin e tyre; dhe t'u mundësojë banorëve të Kosovës ta përdorin TIK-un.<sup>18</sup> Rezultat kryesor i këtij dokumenti lidhur me sigurinë kibernetike ishte themelimi i Ekipit kombëtar për Reagim ndaj Emergjencave Kompjuterike (CERT), që është përgjegjës për hetimin e incidenteve të sigurisë që lidhen me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.<sup>19</sup>

Në këtë kuadër, Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit 2016–2019 është dokumenti më i rëndësishëm i politikave i miratuar nga Qeveria e Kosovës deri më sot. Kjo synon ta sigurojë një mjedis të sigurt të hapësirës kibernetike duke minimizuar dhe parandaluar kërcënimet kibernetike në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.<sup>20</sup> Strategjia nënvizon

**Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit nënvizojnë se autoritetet publike dhe private duhet t'i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore në hapësirën kibernetike**

se autoritetet publike dhe private duhet t'i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore në hapësirën kibernetike dhe se masat e qeverisë për të mbrojtur dhe garantuar sigurinë kibernetike kombëtare duhet t'i respektojnë të drejtat dhe liritë themelore, përfshirë këtu të drejtën për privatësi, qasje të lirë në informacion dhe 'parimet e tjera demokratike.<sup>21</sup> Për më tepër, një nga parimet kyçe të strategjisë është t'i sigurojë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe ta garantojë sigurinë kibernetike duke 'respektuar në të gjitha fazat të drejtat dhe liritë themelore si dhe duke mbrojtur liritë individuale, dhe informatën e identitetin personal, pavarësisht nga etnia, gjinia, mosha dhe feja.<sup>22</sup> Mirëpo, sa i përket zbatimit praktik, plani i veprimit i kësaj strategjie nuk parasheh asnjë aktivitet që ka të bëjë me këtë dimension të sigurisë kibernetike. Edhe përkundrejt faktit që sipas informatave publike të dhëna nga Ministria e Punëve të Brendshme më 4 shkurt 2019, më shumë se 70 për qind e aktiviteteve të parapara sipas planit të veprimit janë kryer,<sup>23</sup> nuk ka kurfarë informatash për vlerësimin e zbatimit të strategjisë pas kësaj date.

13 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji Nr. 06/L - 082), 25 shkurt 2019.

14 Ibid., Neni 1.

15 Ibid., Neni 2.

16 Qeveria e Kosovës, *Projektligji për Sigurinë Kibernetike, 17 korrik 2020*.

17 Ministria e Ekonomisë, Electronic Communication Sector Policy: Digital Agenda for Kosovo 2013–2020, mars 2013.

18 Ibid., fq. 3–4.

19 Ibid., fq. 33.

20 Ministria e Punëve të Brendshme, National Cybersecurity Strategy and Action Plan 2016–2019, dhjetor 2015, fq. 2.

21 Ibid., fq. 12.

22 Ibid., fq. 13.

23 Ministria e Punëve të Brendshme, *Këshillit Shtetëror për Siguri Kibernetike ka vlerësuar zbatimin e strategjisë shtetërore për siguri kibernetike, 4 shkurt 2019*.

Strategjia Shtetërore e Sigurisë Kibernetike i vuri themelet e qeverisjes së sigurisë kibernetike në Kosovë. Para së gjithash, ajo e parashikoi krijimin e postit të Koordinatorit Nacional për Siguri Kibernetike, si dhe të Këshillit Shtetëror për Siguri Kibernetike (KSHSK), për ta forcuar përfshirjen dhe koordinimin shumëpalësh në lidhje me sigurinë e 'hapësirës kibernetike.' KSHSK-ja synon ta forcojë bashkëpunimin edhe brenda qeverisë, edhe me sektorin privat, si dhe t'u ofrojë rekomandime për çështjet strategjike 'niveleve të larta politike.' Sipas Strategjisë, anëtarët 'e përhershëm' të KSHSK-së – palët e interesuara kyçe - janë përfaqësuesit e institucioneve në vijim: Ministrisë së Punëve të Brendshme; Policisë së Kosovës; Agjencisë Kosovare të Mjekësisë Ligjore; Ministrisë së Forcave të Sigurisë së Kosovës (tash Ministrisë së Mbrojtjes); Agjencisë Kosovare të Inteligjencës; Agjencisë së Shoqërisë Informative; Këshillit të Sigurisë së Kosovës; Ministrisë së Drejtësisë; Ministrisë së Ekonomisë; Këshillit Prokurorial të Kosovës; Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Ministrisë së Financave; Doganave të Kosovës; Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministrisë së Punëve të Jashtme; Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare; dhe të Bankës Qendrore të Kosovës. Mirëpo, sipas strategjisë, herë pas here mund të përfshihen edhe ministritë dhe agjencitë e tjera, ndërsa përfaqësuesit e sektorit privat ftohen si anëtarë të shoqëruar të Këshillit.<sup>24</sup> Këshilli mbledhet çdo tre muaj,<sup>25</sup> mirëpo, takimi i tij i fundit, i kryesuar nga Koordinatori Nacional për Siguri Kibernetike u zhvillua në marsin e vitit 2021, dhe që nga atëherë ky organ praktikisht ka qenë jofunksional.<sup>26</sup>

Megjithatë, duhet theksuar se anëtarësia në KSHSK nuk i pasqyron parimet e të drejtave dhe të lirive të njeriut, meqë ky Këshill nuk i përfshin – në mënyrë të përhershme apo të herëpashershme – palët përkatëse të interesit, të tilla si IAPK-në ose organizatat e shoqërisë civile të specializuara për të drejtat e njeriut. Për

më tepër, sipas një përfaqësuesi të IAPK-së – me përjashtim të tryezave të rrumbullakëta, dhe të punëtorive e uebinareve të rralla, e ku çështjet e sigurisë kibernetike u diskutuan shkurtimisht, si tema dytësore – IAPK-së nuk i është kërkuar fare që në ndonjë mënyrë të veçantë të bashkëpunojë me KSHSK-në, dhe as që ta japë mendimin e vet për ndërlidhjen e të drejtave të njeriut me sigurinë kibernetike.<sup>27</sup>

Sa i përket reagimeve emergjente, strategjia parasheh funksionalizimin e CERT-it kombëtar (KOS-CERT) dhe themelimin e CERT-ëve të tjerë, që janë kryesisht përgjegjës për parandalimin dhe reagimin ndaj shkeljeve serioze të sigurisë së rrjetit dhe të informacionit.<sup>28</sup> KOS-CERT, që është pjesë e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), është funksionalizuar në qershor 2016<sup>29</sup> dhe deri në vitin 2020 në Kosovë kanë vepruar më shumë se 50 CERT-ë, përfshirë këtu edhe ata që vepronin brenda qeverisë ekzekutive, agjencive qeveritare, sektorit privat dhe institucioneve akademike. Megjithatë, këta CERT-ë përgjithësisht kanë mungesë të personelit, dhe në raste të shumta u mungon ekspertiza.<sup>30</sup> Mirëpo, Projektligji i ri për Sigurinë Kibernetike<sup>31</sup> do të shfuqizojë Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik.<sup>32</sup> Ky e parasheh themelimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe operacionalizimin e CERT-it brenda kësaj strukture. Miratimi i Projektligjit të ri për Sigurinë Kibernetike mund ta hapë rrugën për forcimin e kapaciteteve aktualisht të kufizuara të CERT-it.

Për më tepër, në vitin 2016 ish-Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK)<sup>33</sup> e miratoi Strategjinë e Sigurisë Kibernetike në MFSK/FSK (2017-2020), me qëllimet kyçe si në vijim: t'i adresojë kërcënimet ndaj MFSK; ta rrisë ndërgjegjësimin e personelit për rreziqet që sjell krimi kibernetik; ta forcojë besueshmërinë dhe

24 Ministria e Punëve të Brendshme, National Cybersecurity Strategy and Action Plan 2016-2019, dhjetor 2015, fq. 19.

25 Global Cyber Security Capacity Centre, Cybersecurity Capacity Review, Republic of Kosovo, mars 2020, fq. 30.

26 Ministria e Punëve të Brendshme, *Mbahet takimi i Këshillit Shtetëror për Siguri Kibernetike, 1 mars 2021.*

27 Intervistë me një përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, maj 2022.

28 Ministria e Punëve të Brendshme, National Cybersecurity Strategy and Action Plan 2016-2019, dhjetor 2015, fq. 23.

29 Global Cyber Security Capacity Centre, Cybersecurity Capacity Review, Republic of Kosovo, mars 2020, fq. 10.

30 Ibid., fq. 35.

31 Qeveria e Kosovës, *Projektligji për Sigurinë Kibernetike, 21 korrik 2020.*

32 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik (Ligji Nr. 03/L-166), 20 korrik 2010.

33 Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës është shndërruar në Ministri të Mbrojtjes me Ligjin Nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 14 dhjetor 2018 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 06/L-122, 4 janar 2019).

sigurinë e sistemeve informative të komunikimit në kuadër të MFSK/FSK; dhe t'i hartojë e rishikojë politikën, udhëzimet dhe procedurat ekzistuese.<sup>34</sup> Sa i përket incidenteve të sigurisë kibernetike, strategjia po ashtu e parasheh edhe operacionalizimin e CERT-it brenda ministrisë,<sup>35</sup> edhe pse CERT-i zyrtarisht është themeluar që më 2015.<sup>36</sup>

Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit (2016–2019), si dhe Strategjia e Sigurisë Kibernetike në MFSK/FSK (2017–2020), kanë skaduar tre, përkatësisht dy vjet më parë, dhe për këtë arsye këto nuk janë të zbatueshme edhe më tutje. Mirëpo Strategjia e re e Sigurisë Kibernetike (2022–2026) është hartuar, edhe pse nuk është miratuar ende nga Qeveria e Kosovës.<sup>37</sup> Për më tepër, Draft Strategjia e Sigurisë së Kosovës (2021–2030)<sup>38</sup> dhe Draft Strategjia e Mbrojtjes së Kosovës<sup>39</sup> janë përgatitur nga qeveria e mëparshme e Kosovës në nëntor, përkatësisht dhjetor 2020, si dokumente sipërore të politikave të sigurisë kombëtare, duke përfshirë këtu edhe ofrimin e udhëzimeve strategjike lidhur me sigurinë kibernetike 2020; mirëpo, për shkak të zgjedhjeve të jashtëzakonshme të shkurtit 2021, ato nuk kanë mundur të miratohen nga kuvendi. Prandaj është e mundur të përfundojmë se që nga viti 2019/2020 siguria kibernetike në Kosovë në fakt është qeverisur pa drejtimin përkatës nga ana e politikave.

Për më tepër, përfaqësuesit, si të akademisë, ashtu edhe të Ministrisë së Ekonomisë, mendojnë se përpjekjet për përparimin e infrastrukturës ligjore që ka të bëjë me sigurinë kibernetike duhet ta përfshijnë zhvendosjen e Direktivës së Sistemeve të Informacionit të Rrjetit (NIS) të BE-së dhe të akteve të përfutuara nënligjore, si dhe hartimin dhe nxjerrjen e Strategjisë së re Kombëtare të Sigurisë Kibernetike.<sup>40</sup> Përfaqësuesit e Policisë së Kosovës/Ministrisë së Punëve të Brendshme theksuan po ashtu se, sa i përket legjislacionit, miratimi i Ligjit

të ri për Sigurinë Kibernetike do ta kishte ndikimin më të drejtpërdrejtë në forcimin e sigurisë kibernetike në Kosovë,<sup>41</sup> meqë projektligji e parasheh zhvendosjen e Direktivës NIS 2016/1148 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 6 korrik 2016 për masat e sigurisë për sistemet e rrjetit dhe të informacionit.<sup>42</sup>

Sipas një përfaqësuesi të KOS-CERT-it, mekanizmat kryesorë institucionalë përgjegjës për zbatimin e masave të sigurisë kibernetike në Kosovë janë Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), Sektori për Luftimin e Krimit Kibernetik i Policisë së Kosovës, Njësia Nacionale për Siguri Kibernetike KOS-CERT, dhe organet më të larta të drejtësisë – të tilla si prokuroria, gjykatat dhe kompanitë e veçanta të specializuara në sigurinë kibernetike dhe në ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura. Lidhur me këtë, ASHI është, ndër të tjera, përgjegjëse për infrastrukturën e teknologjisë së komunikimit të institucioneve të Kosovës – përfshirë këtu grumbullimin, administrimin, përhapjen dhe ruajtjen e të dhënave përmes themelimit të Qendrës Elektronike Shtetërore të të Dhënave – si dhe për sigurinë dhe mbrojtjen e infrastrukturës dhe të dhënave të komunikimeve elektronike.<sup>43</sup> Sektori për Luftimin e Krimit Kibernetik i Policisë së Kosovës është përgjegjës për trajtimin e krimeve që kanë të bëjnë me qasjen në sistemin kompjuterik, ofrimin e materialit pornografik për personat e moshës nën 16-vjeçare, dhe me shkeljen e fshehtësisë së korrespondencës.<sup>44</sup> Aktualisht, KOS-CERT-i është përgjegjës për koordinimin dhe reagimin ndaj incidenteve të raportuara të sigurisë kibernetike, dhe vepron si pikë kontakti për reagimet në nivelin rajonal dhe në atë ndërkombëtar.<sup>45</sup>

Në këtë aspekt, përfaqësues të institucioneve të sigurisë theksojnë se mungesa e domeneve të nivelit më të lartë (TLD-ve) të kodit të shtetit në Kosovë është një rrezik i madh për sigurinë kibernetike, meqë adresat

34 Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës/FSK, *Cybersecurity Strategy in Ministry of Kosovo Security Force/KSF (2017–2020)*, 2016.

35 Ibid.

36 Global Cyber Security Capacity Centre, *Cybersecurity Capacity Review*, Republic of Kosovo, mars 2020, fq. 41.

37 Intervistë me një përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, 19 maj 2022.

38 Qeveria e Kosovës, *Draft-Strategjia e Sigurisë së Kosovës (2021–2030)*, nëntor 2020.

39 Qeveria e Kosovës, *Draft-Strategjia e Mbrojtjes së Kosovës*, dhjetor 2020.

40 Intervistë me Blerim Rexhën, 26 maj 2022, dhe me një përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, 23 maj 2022.

41 Intervistë me një përfaqësues të Policisë së Kosovës dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, 24 maj 2022.

42 Qeveria e Kosovës, *Projektligji për Sigurinë Kibernetike*, 17 korrik 2020.

43 ISA, *Functions of the Agency*, 2022.

44 Ministria e Punëve të Brendshme, *Departamenti i Hetimeve*, 2022.

45 Intervistë me një përfaqësues të KOS-CERT, 26 maj 2022.

e Protokollit të Internetit (IP) të pajisjeve të lidhura në internet në Kosovë drejtohen, ose kah Shqipëria, ose kah Serbia, duke e bërë shumë të vështirë menaxhimin e raporteve të incidenteve. Për më tepër, një përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Brendshme po ashtu nënvizoi nevojën që zyrtarët që specializohen në sigurinë e sistemit të informacionit të emërohen në të gjitha ministritë dhe agjencitë qeveritare, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që kjo luan në garantimin, jo vetëm të sigurisë kibernetike, por edhe të sigurisë kombëtare.<sup>46</sup> Në këtë frymë, një përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes theksoi synimin e kësaj ministrie për themelimin e Qendrës Kombëtare të Trajnimit në Sigurinë Kibernetike, për t'i rritur kapacitetet e sigurisë kibernetike në institucionet e sigurisë së Kosovës.<sup>47</sup>

KOS-CERT-i e ka një platformë online për raportimin e incidenteve kibernetike të bëra ndaj personave dhe qytetarëve juridikë privatë ose publikë, mirëpo kjo fatkeqësisht nuk është duke u shfrytëzuar nga viktimat, meqë ata nuk janë në dijeni se kjo ekziston. Në vend të kësaj, viktimat e krimeve kibernetike incidentet zakonisht ia raportojnë Policisë së Kosovës, e cila këto raste i drejton në Departamentin e saj të Hetimeve, dhe atë në Seksionin për Hetimin e Krimeve Kibernetike.<sup>48</sup> Lidhur me këtë, një përfaqësues i IAPK-së deklaroi se niveli i ndërveprimit lidhur me krimet kibernetike është i kufizuar, dhe se vetëm disa raste që i janë drejtuar IAPK-së kanë pasur të bëjnë me ndërhyrje të mundshme kompjuterike, si cenimi i privatësisë apo i të dhënave personale. Ai po ashtu theksoi se stafi i IAPK-së përgjegjës për hetimin dhe trajtimin e këtyre rasteve nuk është i njohur me kompleksitetin e mjedisit kibernetik dhe implikimet më të gjera të shkeljeve të sigurisë kibernetike.<sup>49</sup>

Përfaqësuesit e institucioneve qeveritare dhe të akademisë kishin pikëpamje të ndryshme lidhur me nivelin e përfshirjes dhe të bashkëpunimit me sektorin privat, akademinë dhe qytetarët në fushën e sigurisë

**Pikëpamjet ishin të ndryshme... lidhur me nivelin e përfshirjes dhe të bashkëpunimit me sektorin privat, akademinë dhe qytetarët në fushën e sigurisë kibernetike**

kibernetike. Një përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë nënvizoi se sektori privat është i përfshirë në të gjitha grupet punuese për hartimin e strategjive, të legjisllacionit parësor dhe dytësor, dhe të dokumenteve të tjera strategjike, dhe se ka bashkëpunim të mirëfilltë me operatorët e komunikimeve elektronike. Këtu si shembuj u dhanë zbatimi i masave të sigurisë të përcaktuara nga Ligji për Komunikimet Elektronike dhe kontributi i tyre në Vlerësimet e Pjekurisë së Sigurisë Kibernetike (CSMA-të).<sup>50</sup> Sipas një përfaqësuesi të Ministrisë së Drejtësisë, edhe pse kjo ministri nuk ka ndonjë rol të drejtpërdrejtë në sigurinë kibernetike, ajo mundëson dhënie të kontributeve nga i tërë komuniteti akademik dhe shoqëria civile, dhe posaçërisht në hartimin e ligjeve që kanë të bëjnë me sigurinë kibernetike.<sup>51</sup> Për më tepër, një përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Brendshme vërejti se qeveria bashkëpunon me sektorin privat, domethënë me bankat, në kuadër të KSHSK,<sup>52</sup> ndërsa një përfaqësues i KOS-CERT-it pohoi se për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme, bashkëpunimi i tij me akademinë ishte i kufizuar në disa vizita studimore disa-orëshe brenda çdo institucioni.<sup>53</sup> Pos kësaj, një përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes

46 Intervistë me një përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, 19 maj 2022.

47 Intervistë me një përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes, 1 qershor 2022.

48 Global Cyber Security Capacity Centre, Cybersecurity Capacity Review, Republic of Kosovo, mars 2020, p. 23.

49 Intervistë me një përfaqësues të IAPK, 27 maj 2022.

50 Intervistë me një përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, 23 maj 2022.

51 Intervistë me një përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, 19 maj 2022.

52 Intervistë me një përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, 19 maj 2022.

53 Intervistë me një përfaqësues të KOS-CERT, 26 maj 2022.



tha se ata kanë punuar me komunitetin akademik, por vetëm në baza të herëpashershme, si për shembull përmes ushtrimeve të përbashkëta që përfshinin institucionet akademike të Kosovës, Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Gardën Kombëtare të Iowa-s.<sup>54</sup>

Është e rëndësishme të vërehet se ekipi 'Runtime Terror' i Universitetit të Prishtinës doli i pari në 'Ushtrimin Ndërkombëtar të Sigurisë Kibernetike 2022' - të organizuar në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të Iowa-s (SHBA), Forcën e Sigurisë së Kosovës, dhe Gardën Kombëtare të Iowa-s - që u zhvillua në fund të majit 2022,<sup>55</sup> duke dëshmuar kështu potencialin e komunitetit akademik në Kosovë për të zhvilluar ekspertizë të sigurisë kibernetike. Megjithatë, një përfaqësues pohoi se akademia dhe shoqëria civile nuk janë të përfaqësuar fare në institucionet e sigurisë kibernetike të

Kosovës, dhe se KOS-CERT-i është institucioni i vetëm që ndërvepron me qytetarët, pasi që është përgjegjës që ata t'i informojë për kërcënimet e mundshme të sigurisë kibernetike. Mirëpo, sipas tij, edhe këto përpjekje praktikisht janë inekzistente.<sup>56</sup>

Prandaj, është e mundur të vijmë në përfundimin se institucionet qeveritare dhe sektori privat - domethënë bankat dhe operatorët e komunikimeve elektronike - punojnë së bashku për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë kibernetike. Mirëpo, bashkëpunimi me akademinë është i kufizuar në ushtrime dhe vizita studimore të herëpashershme, ndërsa ai me qytetarët pothuaj se mungon fare - për shkak të kapaciteteve të kufizuara të institucioneve të sigurisë kibernetike.

---

54 Intervistë me një përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes, 1 qershor 2022.

55 Për hollësi të mëtejme, shih: *Reserve & National Guard Magazine*, [First international cyber-defense competition links Iowa, Kosovo campuses; 19 maj 2022](#); dhe *IscoRE*, [International Cyber Security Exercise; 22 maj 2022](#).

56 Intervistë me Blerim Rexhën, 26 maj 2022.

# Siguria Kibernetike dhe Korniza e të Drejtave të Njeriut

Kjo pjesë shqyrton se a janë masat e sigurisë kibernetike në Kosovë në përputhje me standardet e saj për të drejtat e njeriut, përfshirë edhe zbatimin e mbrojtjes vendore të të drejtave njerëzore. Kjo shqyrton po ashtu edhe përmasën deri në të cilën institucionet e ndryshme koordinohen për t'i mbrojtur këto të drejta në praktikë, si dhe çështjet që prekin grupet e ndryshme gjinore.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e parasheh mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Për sa i përket sigurisë kibernetike, dispozitat më të rëndësishme janë ato që kanë të bëjnë me të drejtën për integritetin personal, lirinë dhe sigurinë, privatësinë, lirinë e besimit, ndërgjegjes dhe të fesë, lirinë e shprehjes, lirinë e tubimit, dhe lirinë e shoqërimit, si dhe të drejtat e fëmijëve. Për më tepër, Kushtetuta e Kosovës parasheh po ashtu mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që garantohen me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, dhe me Marrëveshjen Ndërkombëtare të të Drejtave Qytetare dhe Politike dhe Protokollet e saj, e të cilat, sipas dispozitave të Kushtetutës, janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë. Pos kësaj, ato kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve kombëtare dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Dhe, më e rëndësishmja, Kushtetuta parasheh që të drejtat dhe liritë themelore të interpretohen sipas vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>57</sup>

Edhe pse Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës dhe, si e tillë, as nuk e ka nënshkruar, dhe as nuk e ka ratifikuar Konventën e Budapestit për krimin kibernetik,<sup>58</sup> sipas një profili të përgatitur nga Zyra e Programit të Krimeve Kibernetike të Këshillit të Evropës (C-PROC) për vlerësimin e gjendjes aktuale të zbatimit

të konventës sipas legjislacionit kombëtar, ajo konventën e ka zbatuar përmes pjesëve vijuese të legjislacionit: Ligjit Nr. 03/L-166 për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetikë; Kodit Nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës (2019); Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (2012); dhe Ligjit Nr. 04/L-213 për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale.<sup>59</sup> Për më tepër, sipas Raportit të Komisionit të BE-së për Kosovën në 2021, legjislacioni i Kosovës për krimin kibernetik, në përgjithësi është në përputhje me *acquis* të BE-së.<sup>60</sup>

Megjithatë, duhet vërejtur se Kodi Penal nuk i saktëson të gjitha veprat penale që kanë të bëjnë me krimin kibernetik, të cilat janë të përcaktuara me Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik.<sup>61</sup> Ky ligj përfshin veprat penale që kanë të bëjnë me konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave të sistemeve kompjuterike; përgjimin e paautorizuar të të dhënave; bartjen e paautorizuar të të dhënave; pengimin e funksionimit të sistemit kompjuterik; prodhimin e paautorizuar të të dhënave; posedimin dhe përpjekjen për të kryer vepra penale; veprat penale të ndërlidhura me kompjuterin; humbjen e pasurive; dhe pornografinë e fëmijëve përmes sistemeve kompjuterike. Mirëpo Kodi Penal e përfshin edhe abuzimin e fëmijëve në pornografi; lëshimin e çeqeve të pambuluara ose të rreme dhe keqpërdorimin e karteleve bankare ose të kreditit; vjedhjen e identitetit dhe të qasjes në pajisje; ndërhyrjen në sistemet kompjuterike; dhe shkeljen e të drejtave të patentës dhe të drejtave të autorit. Së fundi, ashtu siç u përmend më sipër, Ligji për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike<sup>62</sup> i saktëson detyrimet dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse shtetërore lidhur me sigurimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut sa i përket përgjimit të ligjshëm, përfshirë këtu edhe procedurat për mbikëqyrjen e zbatimit të tij.

57 Constitute, *Kosovo's Constitution of 2008 with Amendments through 2016, 27 prill 2022*.

58 Këshilli i Evropës, *Budapest Convention on Cyber Crimes*, 23 nëntor 2001.

59 Këshilli i Evropës, *Kosovo Cyber Crime Legislation: Domestic Equivalent to the Provisions of the Budapest Convention*.

60 Komisioni Evropian, *Kosovo Report 2021, 19 tetor 2021, fq. 40*.

61 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, *Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetikë (Ligji Nr. 03/L-166)*, 20 korrik 2010.

62 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, *Ligji për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike (Ligji Nr. 05/L - 030)*, 13 korrik 2015.

Mirëpo, sipas Raportit të Komisionit të BE-së për Kosovën në 2021, ndërkohë që korniza ligjore e Kosovës garanton mbrojtjen e të drejtave themelore dhe është në pajtim me standardet evropiane, zbatimi i legjislacionit për të drejtat e njeriut – njësoj si edhe mbikëqyrja dhe koordinimi i mekanizmave ekzistues për të drejtat e njeriut – mbetet sfidë. Raporti gjithashtu nënvizon se ndërsa Kosova është ende në procesin e zhvillimit të një sistemi gjyqësor funksional, institucionet në fakt janë mjaft të ngadalta, joefikase dhe të prirura për ndikim politik.<sup>63</sup>

Komisioni i BE-së konstaton se përpjekjet për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave të krimit kibernetik kanë përparuar, me 53 raste të filluara në Kosovë në vitin 2020, mirëpo gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar kanë njohuri të pamjaftueshme dhe trajnim të kufizuar për krimin kibernetik.<sup>64</sup> Për më tepër, brenda sistemit gjyqësor të Kosovës nuk ekziston asnjë njësi e vetme e specializuar që do të merrej me hetimet e krimit kibernetik, dhe këto hetime zakonisht kryhen nga Sektori për Hetimin e Krimit Kibernetik të Policisë së Kosovës. Në kuadër të kësaj, raporti thekson se incidentet që përfshijnë gjuhën fyese dhe të urrejtjes në mediat online dhe në ato sociale shpesh nuk ndiqen në mënyrë të efektshme gjyqësore.<sup>65</sup>

Për sa i përket diskriminimit, ndërkohë që janë raportuar një varg incidentesh të gjuhës së urrejtjes dhe të krimeve të urrejtjes kundër komunitetit lezbian, homoseksual, biseksual, transgjinnor, interseksual, queer dhe aseksual (LGBTIQ+), dhe atë posaçërisht në mediat sociale, këto raste nuk janë hetuar dhe nuk janë sjellur gjithmonë para drejtësisë ashtu siç është dashur.<sup>66</sup> Për më tepër, sipas një raporti të politikave të botuar nga Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) në dhjetor të vitit 2018, këto mangësi janë të shkaktuara kryesisht nga faktorët në vijim: mungesës së trajnimit të institucionalizuar për policinë, prokurorinë dhe gjyqtarët; procedurave të vjetëruara standarde të veprimit të Policisë së Kosovës, të miratuara në vitin 2007, e të cilat nuk janë në përputhje me ligjet për barazi gjinore dhe diskriminim;

homofobisë dhe paragjytimeve në mesin e zyrtarëve të caktuar brenda institucioneve të sundimit të ligjit; dhe faktit që policia shpesh ka dështuar që shkeljet kundër komunitetit LGBTIQ+ t'i trajtojë me seriozitetin e duhur ose që në atë trajtim ta sigurojë konfidencialitetin.<sup>67</sup>

## Siguria Kibernetike dhe e Drejta në Privatësi

Ky seksion analizon shkurtimisht legjislacionin lidhur me sigurinë kibernetike në Kosovë që e rregullon të drejtën e privatësisë, përfshirë këtu hapësirat online, si dhe institucionet përgjegjëse për të reaguar në çështjet e lidhura me sigurinë kibernetike.

E drejta e privatësisë në Kosovë garantohet me nenin 36 të Kushtetutës, që përcakton se 'çdokush e gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta e tij/saj private dhe familjare, paprekshmëria e vendbanimit, dhe konfidencialiteti i korrespondencës, telekomunikimit dhe i komunikimeve të tjera' dhe se 'çdo person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale,' e cila duhet të rregullohet me ligj.<sup>68</sup>

Kosova ka miratuar Ligjin për Përgjimin e Komunikimeve<sup>69</sup> në vitin 2015 për ta rregulluar të drejtën në privatësi. Neni 4 i këtij ligji parashtrohet këto parime bazë: respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të mbrojtura dhe të garantuara me Kushtetutë; pajtueshmërinë me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, përfshirë këtu edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe ndalimin e përgjimit pa vendimin përkatës nga gjykata. Neni 6 përcakton se përgjimet e ligjshme duhet të përfshijnë tri shkallë: (1) parashtrimin e kërkesave për përgjimit nga institucionet e autorizuara me ligj; (2) shqyrtimin, miratimin dhe paraqitjen e kërkesave për

63 Komisioni Evropian, *Kosovo Report 2021*, 19 tetor 2021.

64 Ibid., fq. 42.

65 Ibid., fq. 31.

66 Ibid., fq. 35.

67 Qosaj-Mustafa Ariana dhe Morina Donjeta, *Qasja në Drejtësi e Viktimave të Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë: Përfundimi i Mosnjdëshkimit të Autorëve të Krimit, Raport i Politikave, KIPRED, dhjetor 2018.*

68 Ibid.

69 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike (Ligji Nr. 05/L - 030), 13 korrik 2015.

përgjim; dhe (3) urdhrin e gjykatës për përgjim. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Përgjimit të Komunikimeve, post ky i themeluar me Ligjin për Përgjimin e Komunikimeve, funksionon në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK). Komisioneri kontrollon ligjshmërinë e përgjimeve të komunikimeve në bazë vjetore dhe shkeljet e mundshme ia raporton KGJK-së dhe Prokurorit të Shtetit, si dhe komisioneve përkatëse parlamentare të Kuvendit të Kosovës. Para miratimit të këtij ligji, mungesa e kornizës ligjore për bashkëpunim midis institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë dhe drejtësisë në Kosovë bëri që përgjimet të jenë sfiduese dhe rezultoi në marrëveshje të pavarura midis këtyre institucioneve dhe operatorëve të telekomunikacionit.<sup>70</sup>

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<sup>71</sup> përcakton sanksionet e mundshme për shkeljen e të dhënave personale, përfshirë shkeljet e dispozitave për sigurinë e të dhënave personale; për marketingun e drejtpërdrejtë; për mbikëqyrjet me video, të tilla si mbikëqyrja në ndërtesat e banimit dhe në zonat e punës; dhe për biometrinë, në sektorin publik dhe privat.<sup>72</sup> Ligji është në përputhje me Rregulloren e BE-së (BE) 2016/679 të datës 27 prill 2016 për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla.<sup>73</sup> Megjithatë, një përfaqësues i Agjencisë për Informim dhe Privatësi pohon se ka boshllëqe në këtë ligj dhe se ky duhet të përfshijë masa specifike për rregullimin e mbrojtjes së të dhënave duke pasur parasysh evoluimin e zhvillimeve teknologjike.<sup>74</sup>

Kodi Penal nuk i saktëson të gjitha veprat penale që lidhen me krimet kibernetike dhe të drejtën e privatësisë. Ai përcakton vetëm se 'kushdo që, pa autorizim, fotografon, filmon, inçizon, ose në ndonjë mënyrë tjetër regjistron një person tjetër në ambientet e tij/saj personale, ose në çdo vend tjetër ku ai person e ka një pritje të arsyeshme të privatësisë, dhe në këtë mënyrë thel-

bësisht e cenon privatësinë e tjetrit, do të dënohet me gjobë ose me burgim nga një (1) deri në tre (3) vjet,' dhe se 'kushdo që pa autorizim bart, shfaq ose i jep qasje personit të tretë në ndonjë fotografi, film, videokasetë ose në çfarëdo incizimi tjetër të siguruar në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 202, do të dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.'<sup>75</sup>

Sidoqoftë, sipas të dhënave të KGJK, gjatë gjashtë viteve të fundit gjykatat në Kosovë kanë marrë 18 aktgjykime për rastet që kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës së privatësisë.<sup>76</sup> Nëntë nga këto raste u kategorizuan si fotografi apo regjistrime të paautorizuara, katër si ndërhyrje në sistemet kompjuterike, katër si ngacmime, dhe një si detyrim. Dymbëdhjetë prej tyre kishin të bënin me ngacmime kibernetike dhe imazhe intime jo-konsensuale, shprehje këto që nuk përmenden në Kodin Penal.

Të gjitha viktimat në këto raste ishin femra, që tregojnë se ato janë shënjestrat kryesore të këtyre veprave kriminale. Analiza e këtyre rasteve tregon se autorët meshkuj i kryen këto veprime kriminale për të denigruar integritetin personal dhe dinjitetin e viktimave femra, përmes shpërndarjes së fotove dhe të videove familjes apo miqve të viktimës, ose përmes mediave të ndryshme sociale online dhe platformave pornografike.

Sipas Këshillit të Evropës, ngacmimi kibernetik shpesh i merr në shënjestër gratë dhe vajzat – që referohet si 'dhuna kibernetike ndaj grave dhe vajzave' – dhe ky përfshin: e-mailat e padëshiruar ose mesazhet e tjera seksualisht eksplicite, shpërndarjet ofenduese në mediat sociale ose platformat tjera, kërcënimi i dhunës fizike ose seksuale, ngacmimi kibernetik, dhe imazhet intime jo-konsensuale.<sup>77</sup> Ndërkaq, sipas Institutit Evropian për Barazinë Gjinore, shprehja imazhe intime jo-konsensuale ka të bëjë me shpërndarjen online të fotografive apo videove seksualisht grafike pa pëlqimin e individit në ato imazhe.<sup>78</sup>

70 Kursani, Shpend, *Lawful Interception of Telecommunications in Kosovo: Security Implications*, 27 tetor 2019.

71 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji Nr. 06/L - 082), 25 shkurt 2019.

72 Ibid., nenet 91-107.

73 Ibid., neni. 1.2.

74 Intervistë me një përfaqësues të Agjencisë për Informacion dhe Privatësi, 19 maj 2022.

75 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Kodi Nr. 06/L-074), 14 janar 2019.

76 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Aktgjykimet*.

77 Council of Europe, *Types of Cyberviolence*.

78 European Institute for Gender Equality, Definition of 'revenge porn.'

Të dhënat e KGJK tregojnë se shumica e autorëve në Kosovë janë dënuar me gjobë. Në disa raste, dënimet me burg, me pëlqimin e personave të dënuar, janë zëvendësuar me gjoba, dhe në disa raste të tjera gjykata ka shqiptuar dënime me kusht. Mirëpo, këtu duhet theksuar se organizata të besueshme ndërkombëtare të medias kanë raportuar se ligjet e BE-së për privatësinë kanë dështuar edhe për viktimat e pornografisë jo-konsensuale. Kjo e ka shtyrë një numër shtetesh anëtare të BE-së që këtë çështje ta marrin në duart e veta duke përvetësuar legjislacion kombëtar që i kriminalizon këto veprime. Kështu, për shembull, në dhjetor 2020, Irlanda miratoi një legjislacion të rreptë për shkelësit në internet, e që nënkuptonte se ata mund të përballëshin me deri në dhjetë vjet burg, dhe me gjoba të pakufizuara.<sup>79</sup> Edhe pse Kodi Penal i Kosovës këto raste i konsideron si vepra penale, edhe përkundrejt asaj se nuk e përdor terminologjinë e duhur, qeveria duhet t'i ndjekë praktikën më të mira të shteteve të BE-së dhe ta ofrojë një legjislacion që sanksionon ngacmimet kibernetike dhe pornografinë hakmarrëse, dhe që vendos dënime të rënda për të mbrojtur në një mënyrë efektive të drejtën e qytetarëve të vet për privatësi – dhe posaçërisht atë të grave, që janë viktimat kryesore të këtyre veprimeve kriminale.

Raporti i Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës për vendosjen e kamerave të sigurisë në disa qeli të burgosurave në Qendrën Korrektuese të Grave në Lipjan e paraqet një rast tjetër interesant lidhur me të drejtat e privatësisë.<sup>80</sup> Sipas këtij Raporti, Qendra ka vendosur një mori kamerash të sigurisë për t'i mbrojtur të burgosurat që vuajnë nga probleme serioze të shëndetit mendor e që kanë të bëjnë me vetëlëndime ose me përpjekje për vetëvrasje. Ky vjen në përfundimin se ndërkohë që ishte një qëllim legjitim për këtë masë, një veprim i tillë përbën shkelje të së drejtës së privatësisë; vendosja e kamerave të sigurisë në qeli të caktuara duhet të rregullohet me akte dhe procedura ligjore që ofrojnë garancat dhe procedurat e domosdoshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe posaçërisht të drejtën e privatësisë.<sup>81</sup>

Në kuadër të kësaj, një aktivist i shoqërisë civile thotë se ka pasur raste të shumta që pjesëtarët e komunitetit LGBTIQ+ të jenë viktimat të krimit kibernetik që përfshin shkelje të privatësisë në hapësirën online – dhe zakonisht përmes profileve të rreme të mediave sociale. Shumë nga këto raste janë denoncuar në polici, mirëpo kjo deri më tash nuk ia ka dalë ta identifikojë asnjërin nga autorët. Për shkak të mungesës së një hetimi efektiv, ky aktivist vërejtë se edhe pse incidentet e tilla vazhdojnë të ndodhin edhe më tutje, ato nuk raportohen më në polici.<sup>82</sup> Sa i përket komuniteteve joshumicë, në vitin 2019 një grua rome u sulmua pasi që një grup të rinjsh e fotografuan atë në një stacion autobusësh në Malishevë, dhe foton e saj e shpërndanë në internet me shkrimin përcjellës: 'Kini kujdes edhe në shtëpinë tuaj.'<sup>83</sup> Si rezultat i këtyre pretendimeve të rreme, që çuan në raportime të mediave dixhitale dhe në maltretime kibernetike në internet, kjo grua u sulmua dy herë – një herë në Lipjan dhe herën e dytë në Ferizaj.

Këto raste ilustron rreziqet që i parashtrojnë incidentet e krimit kibernetik që cenon të drejtën e privatësisë, e të cilat mund të kenë pasoja të rënda për viktimat nëse ato nuk mbrohen në mënyrë efektive me legjislacion, ose nëse rastet nuk hetohen siç duhet nga Policia e Kosovës dhe institucionet tjera përkatëse.

## Siguria Kibernetike dhe Liria e Shprehjes

Kjo pjesë i shqyrton çështjet kyçe që kanë të bëjnë me censurën online dhe me legjislacionin që ka të bëjë me sigurinë kibernetike dhe lirinë e shprehjes në Kosovë. E drejta e lirisë së shprehjes në Kosovë garantohet me nenin 40 të Kushtetutës së saj, i cili atë e përcakton si të drejtën 'për t'u shprehur, për të shpërndarë dhe marrë informacion, mendime dhe mesazhe të tjera pa

79 Pogatchnik, Shawn, *Ireland brings in tough laws on revenge porn and online bullying*, Politiko, 17 dhjetor 2020.

80 Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, *Raport me rekomandime, ex officio nr. 95/2022 përkitazi me instalimin e kamerave të sigurisë në disa qeli të burgosurve në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan*, 25 shkurt 2022.

81 Ibid.

82 Intervistë me Arbër Nuhiun, 2 qershor 2022.

83 Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, *Raport me rekomandime Ex-Officio 468-2019 përkitazi me detyrimet pozitive në rastin e Z. S. të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 3 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*, 9 dhjetor 2019.

pengesë.<sup>84</sup> Neni përcakton se kjo liri mund të kufizohet me ligj 'kur kjo është e nevojshme për ta parandaluar nxitjen ose provokimin e dhunës dhe të armiqësive për arsye race, kombësie, etnie ose feje.'<sup>85</sup> Për më tepër, Kushtetuta në mënyrë eksplicite e ndalon censurën,<sup>86</sup> e që në aspektin juridik e përfshin edhe censurën online. Legjislacioni i Kosovës dezinformimin nuk e trajton përmes kornizave ligjore civile apo penale. Në këtë kontekst, sipas një përfaqësuesi të IAPK-së, të gjitha garancat e dhëna nga korniza ligjore e Kosovës vlejnë po ashtu edhe për sigurinë kibernetike.<sup>87</sup> Po ashtu, rastet e shpifjes dhe të fyerjes trajtohen nga Ligji Civil për Shpifjen dhe Fyerjen,<sup>88</sup> ndërsa Kodi Penal penalizon veprimet e urrejtjes (neni 2.12) dhe ato që nxisin përçarje dhe jotolerancë (neni 141).

Në këtë kontekst është e rëndësishme që Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën në 2021 nënvizon se Kushtetuta dhe korniza ligjore e Kosovës garantojnë lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave. Në raport thuhet se, përgjithësisht, ligjet e medias dhe ato që kanë të bëjnë me shpifjen dhe qasjen në informacion janë në pajtim me standardet e Këshillit të Evropës dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, ky Raport po ashtu shpreh shqetësimin që Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë nuk përputhet me standardet dhe praktikën më të mira evropiane, dhe se kapacitetet administrative të qeverisë për t'u marrë me çështjet që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes nuk janë të mjaftueshme.<sup>89</sup> Për më tepër, ky ngrit edhe çështjen lidhur me fushatat e shpifjeve dhe të kërcënimeve publike, dhe posaçërisht atë të sulmeve fizike ndaj gazetarëve, duke nënvizuar se të gjitha kërcënimet e kësaj natyre nuk raportohen te autoritetet përkatëse. Pos kësaj, ky thotë edhe se liria e shprehjes dhe autocensurimi në veri të Kosovës janë çështje e një shqetësimi të veçantë.<sup>90</sup>

Në po këtë frymë, Raporti Vendor i Departamentit Amerikan të Shtetit për Praktikën e të Drejtave të Njeriut në Kosovë gjatë vitit 2021 konstaton se, përgjithësisht, qeveria e Kosovës ka respektuar të drejtën e lirisë së shprehjes, por nënvizon edhe atë se ka pasur raporte të besueshme për zyrtarë publikë, politikanë, biznese, dhe grupe fetare, që i kanë frikësuar përfaqësuesit e mediave. Ky raport po ashtu tregoi se nuk ka pasur raste të censurës së drejtpërdrejtë të mediave të shkruara ose elektronike, por presioni dhe kërcënimet nga politikanët dhe grupet e organizuara kriminale shpesh kanë rezultuar me autocensurë nga ana e gazetarëve.<sup>91</sup> Nga ana tjetër, raporti thekson se qeveria as nuk e ka kufizuar dhe as nuk e ka ndërprerë qasjen në internet, dhe se nuk ka censuruar përmbajtjet online dhe nuk ka kryer asnjë mbikëqyrje të komunikimeve private online në mungesë të një autoriteti të duhur ligjor.<sup>92</sup>

Një përfaqësues i shoqërisë civile mendon se gjatë viteve të fundit janë shfaqur tri sfida të mëdha lidhur me lirinë e shprehjes dhe sigurinë kibernetike: maltretimi kibernetik ose gjuha e urrejtjes, dezinformimi dhe ngacmimi online.<sup>93</sup> Liria e shprehjes dhe të drejtat e njeriut, sipas tij, duhet të vlejnë për të gjitha llojet e komunikimit, përfshirë edhe internetin. Ai gjithashtu theksoi se ndërsa OKB-ja lirinë e fjalës dhe të shprehjes në hapësirën kibernetike e kishte shpallur si pjesë themelore të të drejtave të njeriut, kjo ka një çmim për miliona shfrytëzues të internetit, të cilët çdo ditë maltretohen dhe i ekspozohen gjuhës së urrejtjes dhe mashtrimit. Për më tepër, ai pohon se ligjet e sigurisë kibernetike kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat e njeriut, dhe posaçërisht në të drejtën për privatësi dhe në lirinë e shprehjes, e të cilat kontribuojnë në zhvillim, demokraci dhe në dialog. Sipas mendimit të tij, këto ligje janë të pamjaftueshme për të trajtuar çështjet e ngritura më sipër, meqë identifikimi i atyre që përdorin gjuhën e urrejtjes, dhe i ngacmuesve e mashtruesve, është, ose i ngadalshëm, ose, në shumicën e rasteve, nuk ndodh fare.<sup>94</sup>

84 *Constitute, Kosovo's Constitution of 2008 with Amendments through 2016, 27 prill 2022.*

85 *Ibid.*

86 *Ibid.*, neni 42.2.

87 Intervistë me një përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, 27 maj 2022.

88 *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Ligji Nr. 02/L-65), 1 maj 2008.*

89 *European Commission, Kosovo Report 2021, 19 tetor 2021.*

90 *Ibid.*, fq. 30.

91 *US State Department, Kosovo 2021 Report on Human Right Practices, 2021, fq. 14-15.*

92 *Ibid.*, fq. 16.

93 Intervistë me Adrian Zeqirin, 3 qershor 2022.

94 *Ibid.*

## Siguria Kibernetike dhe Liria e Tubimit Paqësor

Kjo pjesë analizon legjislacionin e Kosovës që ka të bëjë me të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe shkeljet e mundshme të sigurisë kibernetike, si dhe reagimet nga aktet dhe institucionet përkatëse. Nenet 43 dhe 44 të Kushtetutës garantojnë të drejtën e lirisë së tubimit dhe të organizimit paqësor. Këto të drejta parashihen edhe me Ligjin për Tubimet Publike<sup>95</sup> dhe me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.<sup>96</sup>

Megjithatë, legjislacioni në Kosovë lidhur me të drejtën e tubimit paqësor është ende i vjetëruar në krahasim me atë të lirisë së asociimit – edhe përkundrejt një vargu përpjekjesh për ta freskuar atë. Koncept Dokumenti për Tubimet Publike të cilin në mars 2018 e hartoi Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, identifikoi çështje të shumta lidhur me zbatimin e Ligjit për Tubimet Publike të vitit 2009, përfshirë këtu boshllëqet dhe mospërputhjet ligjore, paqartësitë, si dhe disa mospërputhje me Kodin Penal të Kosovës.<sup>97</sup> Rrjedhimisht, qeveria hartoi një ligj të ri për tubimet publike dhe, më 21 gusht 2020, kryeministri i atëhershëm, Avdullah Hoti, kërkoi një mendimin e Komisionit të Venedikut nëse ky u përmbahej praktikave, standardeve dhe normave më të mira ndërkombëtare.<sup>98</sup>

Komisioni i Venedikut i dha disa komente dhe konkluzione për këtë projektligj, dhe i ngriti tri çështje kyçe që kanë të bëjnë me sigurinë kibernetike. E para kishte të bënte me kërkesën për ta identifikuar organizatorin për tubimet publike, meqë mediat sociale bëjnë të mundur që tubimet të organizohen në një mënyrë joformale; në këtë rast, sipas mendimit të Komisionit të Venedikut, mungesa e një organizatori të identifikueshëm nuk duhet të cenojë të drejtën e lirisë së tubimit për të gjitha tubimet. Në këtë frymë, Komisioni i Venedikut pohoi se projektligji duhet të vendosë një procedurë për t'i lehtësuar tubimet publike që nuk organizohen nga një person apo grup i identifikueshëm.<sup>99</sup>

Çështja e dytë ka të bëjë me imazhet dhe regjistrimet dixhitale nga autoritetet; Neni 12 pika 8 e projektligjit thotë se 'inçizimet, filmimet dhe fotografitë hidhen menjëherë pas tubimit, në rast se nuk janë të nevojshme,' gjë që sipas Komisionit të Venedikut nuk ka lidhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe nuk arrin ta saktësojë kohëzgjatjen maksimale për ruajtjen e të dhënave. Komisioni i Venedikut po ashtu konstatoi se shprehja 'në rast se nuk nevojiten' është tejet e paqartë dhe se autoriteteve u jep tepër shumë liri veprimi, gjë që ngrit shqetësime serioze për mbrojtjen e të dhënave të pjesëmarrësve në tubimet publike. Ngjashëm, opinioni thekson nevojën për të siguruar që projektligji të jetë në pajtim me Udhëzimet e Përbashkëta për Lirinë e Tubimit Paqësor të Komisionit të Venedikut – Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, të cilat kërkojnë që imazhet dixhitale të organizatorëve dhe pjesëmarrësve në tubime të mos regjistrohen nga autoritetet, me përjashtim të rasteve kur kjo është e autorizuar me ligj. Po ashtu, opinioni kërkon që legjislacioni dhe politikat përkatëse që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe përpunimin e informacionit në lidhje me tubimet duhet t'i integrojnë testet e ligjshmërisë, të domosdoshmërisë dhe të proporcionalitetit. Komisioni i Venedikut po ashtu kërkoi që ligji të shtojë referenca të orientuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave – çfarë janë Ligji për Kundërvajtjet, Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe se shprehja 'në rast se ato nuk nevojiten' nuk duhet të përdoret në nenin e sipërpërmendur të projektligjit.<sup>100</sup> Së fundi, ai ngriti shqetësime për mungesën e dispozitave për tubimet online në projektligj, i cili, rrjedhimisht, qytetarëve nuk u ofron të drejtën ligjore për të mbajtur tubime publike online; komisioni rekomandon përfshirjen e një dispozite ligjore për të rregulluar këtë çështje.<sup>101</sup>

Mirëpo, sipas një interpretimi të dhënë nga Raporti për Lirinë e Internetit në Ballkanin Perëndimor, qytetarët e Kosovës janë të lirë për të përdorur platformat e internetit, përfshirë mediat sociale, për të organizuar tubime paqësore, meqë nuk ka kufizime ligjore për lirinë e inter-

95 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Tubimet Publike (Ligji Nr. 03/L-118), 15 prill 2009.

96 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare (Ligji Nr. 06/L-043), 24 prill 2009.

97 Ministria e Punëve të Brendshme, Koncept Dokumenti për Tubimet Publike, mars 2018.

98 Venice Commission, *Kosovo: Opinion on the Draft Law on Public Gathering*, 9 tetor 2020.

99 Ibid., fq. 11.

100 Ibid., fq. 15.

101 Ibid., fq. 17.



netit.<sup>102</sup> Në kuadër të kësaj, një përfaqësues i Agjencisë për Informim dhe Privatësi ka deklaruar se përdorimi i mbikëqyrjes biometrike, në parim, nuk lejohet, pos në rastet e veçanta të parapara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.<sup>103</sup> Për më tepër, Raporti i Praktikave të të Drejtave të Njeriut në Kosovë për vitin 2021 i Departamentit të Shtetit nënvizon se qeveria e Kosovës, as nuk e ka kufizuar, dhe as nuk e ka ndërprerë qasjen në internet; dhe ajo as nuk i ka mbikëqyruar komunikimet private online pa autoritetin e duhur ligjor.<sup>104</sup>

Mirëpo, një drejtues i shoqërisë civile tha se kishin hasur në ngjarje të shumta, të zhvilluara qoftë në internet, apo sy më sy, ku pjesëmarrësve nuk u ishte kërkuar kurfarë leje për t'i fotografuar, apo për t'i botuar fotot e tyre në faqet zyrtare të organizatorëve në internet. Ata shprehën shqetësimin se kjo, jo vetëm që e shkel të drejtën e pjesëmarrësit për privatësi, por po ashtu mund të çojë në identifikimin e viktimave të shumta të mundshme.<sup>105</sup> Për më tepër, ata dinin për disa raste kur njohja e fytyrës kishte çuar në dhunë kundër aktivistëve të LGBTIQA+. Sipas tyre, përhapja në rrjetet sociale e fotografive me fytyra të pafshehura ka bërë që viktimat të përballen me gjuhë të vrazhdë urrejtjeje, me kërcënime kibernetike, dhe madje edhe me dhunë fizike, ose që të konsiderohen të papranueshëm nga familjet e tyre. Pos kësaj, ata vërejtën se ndërkohë që policia ishte përfshirë në rastet e raportuara, për shkak të mungesës së besimit në institucionet qeveritare, shumë nga këto raste nuk ishin raportuar fare. Ata theksuan se organizatat vendore të shoqërisë civile rëndom janë të parat që raportojnë dhe reagojnë ndaj këtyre shkeljeve të të drejtave, dhe ato shpeshherë këto raste i ndjekin edhe më tutje.<sup>106</sup>

Një udhëheqës i shoqërisë civile i komunitetit LGBTIQA+ foli për rastet që kanë të bëjnë me paradën e parë dhe të dytë të krenarisë në Kosovë, ku që të dyjat janë shpallur publikisht, dhe ku organizatorët dhe anëtarët e komunitetit u janë nënshtruar kërcënimeve. Gjatë paradës së parë, kërcënimi u konsiderua si shumë i rrezikshëm dhe si rrjedhojë u angazhuan forca policore, duke përfshirë

edhe vendosjen e snajperëve në kulmin e hotelit Grand që ndodhet në qendër të Prishtinës. Një vit më pas, organizatorët morën një tjetër kërcënim online që u raportua në Policinë e Kosovës, nga dikush me IP adresë në Zvicër. Sidoqoftë, policia përsëri angazhoi oficerët snajperistë për ta garantuar sigurinë e pjesëmarrësve, në mesin e të cilëve përfshihej edhe kryeministri dhe anëtarë të shumtë të trupit diplomatik të akredituar në Prishtinë. Edhe përkundrejt një vargu kërcënimesh gjatë viteve të fundit, paradat e krenarisë janë organizuar dhe zhvilluar pa ndonjë problem të madh.<sup>107</sup>

## Siguria Kibernetike dhe Anti-Diskriminimi

Kjo pjesë do të analizojë vetëdijen kundër diskriminimit në sigurinë kibernetike në kuadrin e kornizës legjislative dhe institucionale të Kosovës, si dhe pabarazitë e mundshme në qasjen në sigurinë kibernetike për grupet e cenushme.

Në këtë aspekt, neni 24 i Kushtetutës së Kosovës mbron nga diskriminimi, në kombinim me zbatimin e normave të përcaktuara juridike ndërkombëtare, dhe posaçërisht me legjislacionin e OKB-së dhe atë evropian për të drejtat e njeriut dhe kundër diskriminimit (neni 22), si dhe me sigurimin që dispozitat e të drejtave të njeriut do të jenë në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (neni 53). Legjislacioni anti-diskriminues i Kosovës u përparua më tutje në vitin 2015, me shpalljen e Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore dhe Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Për sa i përket antidiskriminimit dhe sigurisë kibernetike, sipas një raporti për lirinë e internetit në Ballkanin Perëndimor, qasja në internet është e disponueshme me një çmim të arsyeshëm për të gjitha grupet e popullsisë

102 Civil Rights Defenders, *Report on the Freedom of Internet in the Western Balkans, 2020*, fq. 14.

103 Radio Evropa e Lirë, *Qeveria e Kosovës analizon kontratat për kamerat kineze*, 4 shkurt 2022.

104 US State Department, *Kosovo 2021 Report on Human Rights Practices*, 2021, fq. 16.

105 Intervistë me Adrian Zeqirin, 3 qershor 2022.

106 Ibid.

107 Intervistë me Arbër Nuhiun, 2 qershor 2022.



dhe atë pa diskriminim. Raporti po ashtu konstaton se qeveria është duke marrë masa për të siguruar që edhe individët me të ardhura të ulëta të kenë qasje në internet, dhe posaçërisht ata në zonat e thella rurale, si dhe atë se ofruesit e shërbimeve të internetit, si rregull i përgjithshëm, trafikun e internetit e trajtojnë në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.<sup>108</sup>

Megjithatë, një udhëheqës i shoqërisë civile pohoi se një fushë kyçe e shqetësimit janë çështjet e shëndetit mendor që ndërlidhen me gjuhën e urrejtjes, ngacmimin kibernetik dhe maltretimet – dhe posaçërisht siguria online e grupeve të cenushme, si gratë, romët dhe komunitetet LGBTQIA+. Përvojat e urrejtjes në internet ndikojnë në lirinë e njerëzve për t'i shprehur ndjenjat ose pikëpamjet e tyre pa u frikësuar për sigurinë e vet.<sup>109</sup> Ai po ashtu vuri në dukje se një numër i faqeve të rrjeteve sociale ndajnë përmbajtje që përfshin gjuhë të papërshtatshme të urrejtjes kundër komunitetin LGBTQIA+ ose paragjykitime ndaj komuniteteve jo-shumicë, dhe posaçërisht ndaj komunitetit rom. Për më tepër, ata pohuan se edhe përkundrejt paraqitjes së ankesave formale nga grupet e diskriminuara, këto çështje nuk janë adresuar.<sup>110</sup> Rasti më i spikatur në Kosovë në këtë drejtim ishte fushata në rrjetet sociale kundër ish të dërguarit të posaçëm presidencial të SHBA-ve për negociatat e paqes midis Serbisë dhe Kosovës, z. Richard Grenell, i cili, për shkak të qëndrimit të tij politik, u ofendua në baza të orientimit të tij seksual; ofendimet më të mëdha janë bërë nga grupi në Facebook 'Me Kryeministrin,' i menaxhuar nga militantët e Vetëvendosjes.<sup>111</sup> Sipas një udhëheqësi të shoqërisë civile, ish-presidenti Thaçi synonte të themelonte një Këshill Konsultativ në kuadër të Zyrës së Presidentit për çështjet që prekin komunitetin LGBTQIA+; mirëpo, procesi u ndërpre për shkak të dorëheqjes së tij si pasojë e aktakuzës nga Odat e Specializuara të Kosovës.<sup>112</sup>

Sipas udhëheqësit të shoqërisë civile, linçimi, dezinformimi dhe lajmet e rreme janë vetëm disa nga çështjet

që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e lirisë së shprehjes në hapësirën kibernetike përmes përhapjes së diskriminimit, shpifjes ose dezinformimit – e të cilat, në raste të caktuara, mund të ndikojnë në sigurinë të qytetarëve të veçantë që i përkasin grupeve të marginalizuara. Ai përmendi një incident që ndodhi në maj 2019, kur një grua rome në media u përshkrua si 'e rrezikshme, e dhunshme dhe hajdute,' pavarësisht nga ajo se ishte intervistuar nga policia dhe u pa se ishte e pafajshme. Rasti u bë lajm kombëtar dhe u shoqërua me një gjuhë të tmerrshme të urrejtjes të përhapur përmes rrjeteve të mediave sociale; qarkulluan video të shumta me dhunë ndaj kësaj gruaje rome për shkak të dezinformatave të përhapura nga portalet jozyrtare dhe të rreme. Në atë kohë, aktorët shtetërorë, përfshirë Policinë e Kosovës dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, u përgjigjën, mirëpo atyre iu desh shumë kohë për të garantuar sigurinë e gruas. Organizatat lokale të shoqërisë civile gjithashtu kërkuan të ndërhyjnë derisa u raportua se gruaja ishte e sigurtë.<sup>113</sup>

Projektligji i ri për sigurinë kibernetike përcakton që shpërndarja online e materialeve pro-gjenocidale, ose e atyre që lidhen me krimet kundër njerëzimit, përfshirë edhe materialet raciste e ksenofobike, do të dënohet si vepër penale.<sup>114</sup> Shpërndarja online e materialeve pro-gjenocidit ose që lidhen me krimet kundër njerëzimit, përkufizohet si 'dhënie ose shpërndarje e qëllimshme në publik nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve që në mënyrë përmbajtësore i mohojnë, ose në mënyrë të ndjeshme i minimizojnë, i miratojnë ose justifikojnë, veprimet që përbëjnë gjenocid ose krime kundër njerëzimit.'<sup>115</sup> Projektligji thotë se kryesisht do të dënohen me burgim nga tre deri në gjashtë vjet.<sup>116</sup> Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike përmes sistemit kompjuterik përkufizohet ndaras si 'dhënie ose shpërndarje e qëllimshme në publik nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve me përmbajtje raciste ose ksenofobike'; projektligji e përcakton që autorët do të dënohen me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.<sup>117</sup>

108 Civil Rights Defenders, *Report on the Freedom of Internet in the Western Balkans, 2020*, fq. 12.

109 Intervistë me Adrian Zeqirin, 3 qershor 2022.

110 Ibid.

111 Insajderi, *Grupi "Me Kryeministrin" bëjnë fushatë dhe e fyejnë Grenellin në baza të orientimit seksual, 27 mars 2020*.

112 Intervistë me Arbër Nuhiun, 2 qershor 2022.

113 Intervistë me Adrian Zeqirin, 3 qershor 2022.

114 Qeveria e Kosovës, *Projektligji për Sigurinë Kibernetike, 21 korrik 2020*.

115 Ibid., neni 15.

116 Ibid.

117 Ibid., neni 17.

# Rrugët përpara

## Edhe përkundrejt një përparimi domethënës ... korniza ligjore mbetet e papërfunduar [dhe] politikat të vjetëruara

Gjetjet e hulumtimit të paraqitura në këtë punim tregojnë se kornizat ligjore dhe të politikave, si dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, të ndërlidhura me sigurinë kibernetike në Kosovë, kanë evoluar që nga Shpallja e Pavarësisë në vitin 2008. Mirëpo, edhe përkundrejt përparimit domethënës, korniza ligjore mbetet e papërfunduar; që nga viti 2019, të gjitha politikat përkatëse janë të vjetëruara, duke nënkuptuar në këtë mënyrë që gjatë tre viteve të fundit, masat e sigurisë kibernetike në Kosovë në fakt janë zbatuar pa udhëzime nga ana e politikave.

Konstatimet e hulumtimit demonstrojnë mungesën e kapaciteteve për t'i adresuar çështjet e sigurisë kibernetike ndër institucionet dhe agjencitë qeveritare, si dhe mungesën e personelit të kualifikuar për sigurinë kibernetike, dhe po ashtu edhe të institucioneve të specializuara për të ofruar trajnime profesionale në këtë fushë. Për më tepër, fushës së sigurisë kibernetike i mungon edhe dimension i të drejtave të njeriut brenda qeverisë dhe gjyqësorit të Kosovës. Edhe pse bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shtetërore të sigurisë kibernetike, akademisë dhe sektorit privat, të paktën në parim, ekziston, ndërveprimi me qytetarët është praktikisht joekzistent. Mirëpo, hulumtimi tregon se qasja në internet është e disponueshme me një çmim të arsyeshëm për të gjitha grupet e popullsisë, pa kurfarë diskriminimi. Për më tepër, qeveria është duke marrë masa për të siguruar qasje në internet për individët me të ardhura të ulëta, dhe posaçërisht në zonat e thella rurale.

Gjetjet e hulumtimit më tutje tregojnë se viktimat kryesore të krimeve kibernetike në lidhje me të drejtat e njeriut janë gratë, komuniteti LGBTIQ+ dhe romët, si dhe, në një masë më të vogël, grupet e tjera të cënueshme. Për më tepër, gjetjet po ashtu tregojnë se autorët e këtyre krimeve marrin dënime më të lehta se ato që ligji i parasheh për krimet e tyre.

Bazuar në gjetjet e këtij punimi, si dhe në sugjerimet e atyre që morën pjesë në hulumtim, është e mundur që palëve të interesuara qeveritare dhe joqeveritare t'u propozohen rekomandimet në vijim:

### Qeverisë së Kosovës:

- ❖ Përfaqësuesi i Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë duhet të bëhet anëtar i përherëshëm i KSHSK-së; përfaqësuesit e organizatave të të drejtave të njeriut dhe të organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë gratë, komunitetet LGBTIQ+ dhe grupet e tjera të cënueshme, duhet të bëhen anëtarë të shoqëruar.
- ❖ Qeveria e Kosovës duhet ta miratojë Strategjinë e re Shtetërore të Sigurisë Kibernetike dhe Planin e Veprimit, që do të ofrojnë udhëzime të politikave për institucionet e sigurisë kibernetike, përfshirë veprimet që duhen ndërmarrë për ta përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut të ndërlidhur me sigurinë kibernetike.
- ❖ Institucionet e Kosovës, duke përfshirë këtu edhe gjyqësorin, duhet t'i rrisin kapacitetet e sigurisë kibernetike ashtu që të përballen me sfidat që lidhen me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë informative dhe numrin në rritje të krimeve kibernetike që prekin të drejtat e njeriut.

- ❖ Duhet të themelohet një Qendër Kombëtare e Trajnimeve për Sigurinë Kibernetike për t'i rritur kapacitetet e sigurisë kibernetike në të gjitha institucionet e sigurisë së Kosovës.
- ❖ Qeveria e Kosovës duhet ta përmirësojë Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ta paraqesë një legjislacion të fuqishëm për t'i sanksionuar incidentet që përfshijnë ngacmime kibernetike dhe imazhe intime jo-konsensuale, duke ndjekur praktikën më të mirë të shteteve të BE-së në këtë fushë, ashtu që ta mbrojë të drejtën e qytetarëve të vet për privatesi – dhe posaçërisht atë të grave që janë viktimat kryesore të këtyre veprave kriminale.
- ❖ Projektligji për tubimet publike duhet të jetë në përputhje me opinionin e Komisionit të Venedikut të datës 9 tetor 2020.
- ❖ Qeveria e Kosovës duhet të zbatojë Direktivën NIS të BE-së, si dhe aktet nënligjore të përfuturara të saj, dhe ta miratojë Ligjin e ri për Sigurinë Kibernetike sa më shpejt që të jetë e mundur.
- ❖ Duhet bërë përpjekje për përmirësimin e koordinimit dhe të bashkëpunimit ndërqeveritar në nismat legjislative dhe ato të politikave lidhur me sigurinë kibernetike dhe reagimet ndaj incidenteve dhe krimeve kibernetike, si dhe për ofrimin e një përcaktimi të qartë të detyrave dhe përgjegjësi të të gjitha institucioneve të sigurisë kibernetike.
- ❖ KOS-CERT-it dhe CERT-ëve të tjerë duhet t'u jipet një mandat i qartë ligjor që i saktëson në hollësi detyrat dhe përgjegjësitë e tyre; ata duhet të përkrahen me staf profesional për të siguruar që t'i kenë kapacitetet e nevojshme për t'i përmbushur përgjegjësitë e tyre.

## Akademia dhe Shoqëria Civile:

- ❖ Trajnimi dixhital duhet të futet në të gjitha nivelet e edukimit për të siguruar që sistemi arsimor të përshtatet për t'iu përgjigjur zhvillimeve teknologjike.
- ❖ Ndërgjegjësimi për sigurinë kibernetike duhet të rritet përmes programeve jashtashkollore të ofruara nga akademitë për grupet e shoqërisë civile dhe studentët.
- ❖ Duhet bërë përpjekje për ta rritur kapacitetin dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë civile për sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të grupeve të cenueshme, të tilla si komunitetet e grave, LGBTIQ+, dhe ato joshumicë, në hapësirën kibernetike.

## Sektori Privat:

- ❖ Duhet të hulumtohen partneritetet e mundshme private-publike për rritjen e kapaciteteve qeveritare dhe joqeveritare në fushën e sigurisë kibernetike.

## Komuniteti Ndërkombëtar:

- ❖ Institucioneve të Kosovës duhet t'u ofrohet ekspertizë ligjore, politike dhe teknike në fushën e sigurisë kibernetike.
- ❖ Duhet përkrahur përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike, dhe posaçërisht ato që synojnë grupet e cenueshme dhe të marginalizuara.

